

UDHËZIM
Nr. 23, datë 1.12.2021

**PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 12, DATË 10.6.2021, “PËR
PROCEDURAT E PRANIMIT E TË EMËRIMIT TË MËSUESIT NË NJË VEND
TË LIRË PUNE NË INSTITUCIONET ARSIMORE PUBLIKE TË ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR DHE PËR ADMINISTRIMIN E PORTALIT ‘MËSUES PËR
SHQIPËRINË’”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 60, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 12, datë 10.6.2021, pas pikës 4, të kreut 2, shtohet pika 4/1, me këtë përmbajtje:

“4/1. Nuk mund të aplikojnë për konkurrim, për të punuar si mësues, pavarësisht faktit të rehabilitimit, të gjithë personat që:

a) janë dënuar nga gjykata me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale kundrejt të miturve;

b) janë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale, që lidhet me institucionet arsimore.”.

Shtojca 5 e udhëzimit zëvendësohet me shtojcën 5, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, institucionet arsimore vendore përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare publike.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Evis Kushi

SHTOJCA 5

VETËDEKLARIMI I GJENDJES GJYQËSORE

Të dhënat e vetëdeklaruesit:

Emër, atësi, mbiemër: _____

Datëlindja: _____

Vendlindja: _____

Dokumenti i identifikimit (kopje bashkëlidhur formularit)

Deklaroj me vullnetin tim të lirë se jam: _____.

i/e padënuar

i/e dënuar

Deklaroj me vullnetin tim të lirë se nuk kam qenë asnjëherë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, për kryerjen e një vepre penale kundrejt të miturve apo për kryerjen e një vepre penale që lidhet me institucionet arsimore, apo i rehabilituar për këto vepra penale.

Emër, mbiemër: _____ Nënshkrimi: _____

Autorizim: Deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta dhe autorizoj kontrollin e vërtetësisë së tyre nga institucioni arsimor vendor përgjegjës për arsimin parauniversitar.

Shënim. Trajtimi i të dhënave personale, në vijim të përdorimit të këtij autorizimi, do të bëhet në përputhje me ligjin nr. 8517, datë 22.7.1999, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar.